



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.07.2024

Nr: 133

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË
KANDIDATËVE PËR KRYETAR BASHKIE NË FLETËN E VOTIMIT, PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4
GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 98, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 8, datë 23.02.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultatit të shortit, duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo kandidat për Kryetar Bashkie në fletën e votimit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI**

Data: 26.07.2024 Nr:133
Ora: 12:00



“Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatëve për Kryetar Bashkie në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”

LIDHJA 1

SHORTI PËR NUMRIN RENDOR TË KANDIDATËVE PËR KRYETAR BASHKIE NË FLETËN E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË

NUMRI	KANDIDATI	SUBJEKTI ZGJEDHOR
1	Vangjel Llambi Tavo	PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
2	Petraq Epaminonda Gjiguria	KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”

